Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipality of Kacanik

**01Nr.104/02-11086/21**
**Kaçanik, 28.05.2021**

Në bazë të nenit 12 dhe 14 lidhur me nenin 17 (a) të Ligjit për Vetëqeverisjes Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 11 të Ligjit Nr. 06/L-092- për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare e Republiks së Kosovës Nr.10/03 Prill 2019), të nenit 23.7 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020- Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, të nenit 6.2 të Statutit të Komunës, të Planit Zhvillimor Komunal të vitit 2010, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr. 104/02-11086/21 prej datës 16.04.2021, duke vepruar sipas Kërkesës së MAPL 020/407/1 prej datës 24.05.2021 – Për harmonizim të aktit Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 104/02-11086 të datës 29.04.2021 me Ligjin 06-L092, respektivisht nenin 6 paragrafi 1.4 (QRK) Nr.09/2020- Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 28 Maj 2021 mori këtë:

**VENDIM**
**PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË, PËR KATËRDHJETË (40) VJET, PRONËN E PALUAJTSHME TË KOMUNËS, ME PROCEDURË TË NEGOCIMI TË OFERTËS**

**1.** Me këtë Vendim, jepet në shfrytëzim afatgjatë për **Katërdhjetë (40) vjet,** prona e paluajtshme e Komunës, personit juridik: **JLG Construction SH.P.K.-Kaçanik, NUI:811498642, me pronar Agron Zeneli-Kaçanik, me procedurë të negocimit të ofertës.**

**2.** Prona e paluajtshme e dhënë në shfrytëzim, e cekur në pikën 1 të këtij Vendimi është:

2.1 Në pronësi të Komunës, Parcela kadastrale **Nr.70917003-01580-0**, Certifikata për të drejtën e pronësisë me numër të lëndës: 941-10857/21 e datës 15.04.2021**,** në sipërfaqe të tërësishme prej **23.379 m$^2$**, Zona Kadastrale Begracë, Pronë shoqërore, Kullosë e klasës së tretë (3).

2.2 Të bëhet parcelizimi i parcelave nr. **70917003-01580-0** dhe **70917003-01579-0,** Zona Kadastrale Begracë për ndarjen e rezervuarit të ujit nga kjo parcelë konform kushteve të pronës me qëllim të dhënies në shfrytëzim.

3 Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në pikën 2 të këtij vendimi është për: **Zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe përmbushjes së interesit të përgjithshëm të qytetarëve, e cila pronë me PZHK të vitit 2010 është e paraparë, Zonë Industriale.**

3.1 Në ofertën e negociuar, JLG Construction SH.P.K.-Kaçanik, planifikon investim në ndërtimin e fabrikës dhe ushtrimin e veprimtarive :

3.1.1 Prodhimin e konstruksioneve metalike të gatshme dhe gjysmë të gatshme për ndërtimin e objekteve të larta të cilat kryesisht do të jenë eksport për ne Evropë – Francë;

3.1.2 Prodhimin e dyerve dhe dritareve të metalit dhe plastikës të destinuar për eksport në Evropë- Francë;

3.1.3 Show room, administrata, Sanitarit etj.

3.1.4 Prodhim të elementeve të tjera metalike për ndërtimin e objekteve të larta sipas nevojave të kontraktuesve në Evropë-Francë.

4. Shuma e planifikuar e investimit e kompanisë së përcaktuar si në dispozitat e pikës 3.1, duke llogaritur rehabilitimin e parcelës, rregullimin e rrugës, ndërtimin e fabrikës dhe objekteve tjera përcjellëse është: 1,000.000.00 (një milion euro) me numër të planifikuar, mesatarisht 70 punëtorë.

5. Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me Kontratë në mes të Kryetarit dhe JLG Construction SH.P.K.-Kaçanik, ku pjesë përbërëse do të jetë, Oferta e JLG Construction SH.P.K.-Kaçanik, NUI:811498642, me pronar Agron Zeneli-Kaçanik, e negociuar për investim në parcelën kadastrale Nr.01580-0 në ZK Begracë.

6. Vendimit i janë bashkangjitur: Propozim Vendimi i Kryetarit të Komunës, Kërkesa e kompanisë, Oferta e kompanisë, Plani dinamik investiv, Certifikatat e pronës, Kopjet e planit, Vendimi Paraprak i KK i vitit 2016, Konkursi publike 2019, 2 Konkurse publike të vitit 2020, Vendimi 01Nr. 104/02-13736/21- për miratimin e Listës së veçantë të pronave që do të jepen në shfrytëzim në vitin 2021; Certifikata e regjistrimit të biznesit NUI 811498642, Vërtetimi tatimor, Qarkullimi bankar dhe Projekti, ndërkaq pas përfundimit të kontratës, prona i kthehet komunës.

7. E drejta e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme, nuk mund të bartet në shfrytëzim të personave të tretë.

8. Për mbikëqyrjen dhe realizimin e kontratës do të kujdeset, Kryetari i Komunës, i cili konform dispozitave të nenit 22 të Ligjit Nr. 06/L-092 – Për Dhënien në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, obligohet të paraqet raport 6 mujor Kuvendit të Komunës dhe raport të veçantë për realizimin dhe përmbushjen e qëllimit të dhënies së pronave komunale në shfrytëzim si dhe veprimet tjera (masat e caktuara ndaj shfrytëzuesit- përshirë edhe rekomandimin për shkëputje të kontratës) që duhet të merren në rast të mosrealizimit të planit dinamik dhe kushteve të përcaktuara në kontratë.

9. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës. Kryetari i Komunës është i obliguar të njoftoj Kuvendin e Komunës, duke përshkruar gjendjen aktuale të pronës si dhe të jap propozime për destinimin e pronës në të ardhmen, konform pikës 2 të nenit 23 të Ligjit me numër të theksuar si më lartë.

10. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit Ekonomik.

11. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen zyrtare të komunës.

**Me këtë vendim njoftohen:** MAPL, Kryetari i Komunës (përmes Zyrës së Kryetarit njoftohet, pala), Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAÇANIKUT * OPŠTINA KAČANIK * REPUBLIKA

DALJE-IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. 020-488/0
-VI-
Data 15-06-2021

# Republika e Kosovës

## Republika Kosova-Republic of Kosovo

### Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Adinitrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administartion*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | **Besim Ilazi,** Kryetar i Komunës së Kaçanikut<br>**Kemal Mërseli,** Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut | |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | **Elbert Krasniqi,** Ministër i MAPL-së<br>**Trim Berisha,** Zv. Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së | |
| Nga: | **Venera Çerkini,** Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave | Datë:<br>01.06.2020<br>Nr.020-488 |
| Zyrtaret përgjegjës:<br>1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | **Xhevat Tafa,** Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br>**Gëzim Sahiti,** Zyrtar i lartë për monitorim të komunave | |
| Lënda: | Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut | |
| Lloji i aktit: | □ Vendim i Kuvendit të Komunës | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendimi 01Nr.104/02-11086/21 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për katërdhjet (40) vjet pronën e paluajtshme të komunës, me procedurë të negocimit të ofertës. |
| I miratuar më datë: 28.05.2021 |
| I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 31.05.2021 |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural **është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi**.
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. 020-407/1
Data 24.05.2021

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK
Data 25 05 21 Vendi KAÇANIK
Nj. org. 01 Numri 60/01-14099 Shtojcë /.

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Adinitrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administartion*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | **Besim Ilazi**, Kryetar i Komunës së Kaçanikut<br>**Kemal Mërseli**, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut | |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | **Elbert Krasniqi**, Ministër i MAPL-së<br>**Trim Berisha**, Zv. Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së | |
| Nga: | **Venera Çerkini**, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave | Datë: 18.05.2020<br>Nr.020-407 |
| Zyrtaret përgjegjës:<br>1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br><br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | **Xhevat Tafa**, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br><br>**Gëzim Sahiti**, Zyrtar i lartë për monitorim të komunave | |
| Lënda: | Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut | |
| Lloji i aktit: | □ Vendim i Kuvendit të Komunës | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendimi 01Nr.104/02-11086/21 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për katërdhjet (40) vjet pronën e paluajtshme të komunës, me procedurë të negocimit të ofertës. |
| I miratuar më datë:29.04.2021 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 07.05.2021 |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson së akti i komunës **është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi**.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

| Nr. | Formulimi në aktin e komunës | Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim |
|---|---|---|
| 1. | Vendimi 01Nr.104/02-11086/21 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për katërdhjet (40) vjet pronën e paluajtshme të komunës, me procedurë të negocimit të ofertës. | Vendimi 01Nr.104/02-11086/21 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për katërdhjet (40) vjet pronën e paluajtshme të komunës, me procedurë të negocimit të ofertës., është në kundërshtim me Ligjin 06/L-092 për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme të komunës, si dhe me Rregulloren 09/2020 për përcaktimin e procedurave te dhënies ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te komunës, *përkatësisht paragrafët 1, dhe 4 të nenit 6 ku sqarohet se: "Komuna duhet të publikon listën e përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës, si dhe listën e veçantë të pronave që planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin vijues deri me 31 dhjetor, duke arsyetuar interesin publik dhe zhvillimin ekonomik të komunës".*<br><br>*"Pronat e paluajtshme të komunës që nuk janë në listën e veçantë të pronave që planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin vijues si dhe nuk kanë miratim paraprak nga Kuvendi i Komunës nuk mund të jepen në shfrytëzim".*<br><br>*Në rastin konkret në vendimin e miratuar për dhënien e pronës në shfrytëzim afatgjatë, Komuna e Kaçanikut nuk ka miratuar në Kuvend vendimin me listën e pronave, dhe nuk ka publikuar në web faqe listën me pronat që planifikohen për dhënien në shfrytëzim gjatë vitit 2021, ashtu siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi.*<br><br>Andaj bazuar në të cekurat më lart, Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, duhet ta rishqyrtoj këtë vendim dhe aktin ta harmonizoj më legjislacionin në fuqi. |

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, kërkon nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës së Kaçanikut që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

2. Industri përpunuese;
3. Industri ushqimore;
4. Parqe industriale dhe teknologjike.

*3.3. Në rastet kur nuk ka interesim për marrjen e pronës së komunës në shfrytëzim nga palët për së paku tre (3) vitet e fundit, me kusht që:*

1. **Prona të jetë në listën e publikuar të pronave për dhënie në shfrytëzim për 3 vite me radhë; dhe**
2. **Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur interesim për marrjen e kësaj prone në shfrytëzim.**

Lëndës duhet ti bashkëngjitet edhe:

*I. Kërkesën e paraqitur nga palët e interesuara për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;*
*II. Ofertën e negociuar për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme;*
*III. Propozim-Vendimin nga Kryetari i Komunës për dhënien në shfrytëzim duke përcaktuar afatin e dhënies në shfrytëzim;*
*IV. Projekti i paraqitur nga investitori dhe plani dinamik i realizimit të investimit;*
*V. Certifikata e pronësisë dhe kopja e planit të pronës e cila jepet në shfrytëzim;*
*VI. Certifikatën e regjistrimit të biznesi, vërtetimi se nuk ka obligime tatimore, qarkullimi bankar për vitin paraprak;*
*VII. Vendimin e KK për dhënien në shfrytëzim sipas negocimit të ofertave nga Kryetari (referenca ne dokumentet hapësinore e përfshirë në kuadër të vendimit apo letra konfirmuese e kryetarit të komunës lidhur me referencën në dokumentet e planifikimit hapësinor)*

## V. DHËNIA NË SHFRYTËZIM E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNË PËR RASTE E VEÇANTA

Procedurat e konkurrimit nuk zbatohen për këto raste:

1. **Kërkesa për dhënien në shfrytëzim bëhet nga institucionet qendrore të Republikës së Kosovës. Kërkesa duhet të jetë e adresuar nga titullari-udhëheqësi i institucionit përkatës si dhe duhet të përcaktohet qëllimi dhe interesi publik i cili është në harmoni të plotë me planin e zhvillimit lokal;**
   **Kërkesa për dhënien në shfrytëzim bëhet nga përfaqësitë diplomatike dhe konsullore, si dhe institucionet ndërkombëtare që kanë marrëveshje me Republikën e Kosovës, Kërkesa duhet të adresohet përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme;**

2. **Kërkesa ka të bëjë me dhënien në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës me qëllim të realizimit të investimeve në sektorin e prodhimit të energjisë së ripërtritshme;**

Lëndës duhet ti bashkëngjitet edhe:

# IV. NEGOCIATAT E KRYETARIT

Neni 11. Kryetari i Komunës ka të drejtë pa zhvilluar procedurat paraprake të negocioj ofertat e paraqitura nga palët e interesuara dhe të paraqet propozimin final për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, për miratim përfundimtar në Kuvendin e Komunës.

Ne kuadër te dhënies se prone përmes negocimit të kryetarit, komuna duhet ti ndjek kushtet si ne vijim:

1. Të jetë e regjistruar si pronë e komunës në regjistrat kadastrale të pronës, të jetë e lirë nga obligimet ndaj palëve të treta, të mos ketë ndonjë kontest pronësor (informatat evidentohen në certifikatën e pronësisë)

2. Të jetë në pajtueshmëri me dokumentet e planifikimit hapësinor (referenca në dokumentet e planifikimit hapësinor vendoset në vendimin e KK apo në një letër të veçantë konfirmuese nga Kryetari i Komunës)

3. Të ketë arsyeshmërinë të interesit publik, të ndikojë në rritjen e zhvillimit ekonomik në komunë, të ndikojë në rritjen e vlerës së pronës; (Të gjitha këto kërkesa duhet të arsyetohen në pjesën e arsyetimit të vendimit të kuvendit të komunës);

4. Të jetë publikuar prona në listën e përgjithshme ose të veçantë të pronave që planifikohen të jepen në shfrytëzim, të jetë miratuar nga Kuvendi me vendim paraprak propozimi i Kryetarit për dhënien në shfrytëzim te pronave; (Pas datës 1 janar 2021 në mungesë të dëshmisë për këto dy kërkesa, lënda do të konsiderohet e pakompletuar);

E drejta e negocimit të Kryetarit të Komunës përcaktohet me dispozitat e sakte lidhur me negocimin [3.1 ose 3.2 ose 3.3]:

*3.1 Në rastet kur vlera e investimit është së paku 10% e buxhetit të përgjithshëm për investime kapitale të komunës të vitit paraprak, por jo me shumë se vlera minimale e përcaktuar me Ligjin për Investime Strategjike në Republikën e Kosovës, sipas sektorëve në vijim:*

1. Energji me Infrastrukturë dhe Miniera; Transport dhe Telekomunikacion dhe Shëndetësi, vlera e investimit duhet të jetë minimum 10% e investimeve kapitale, por jo më shumë së 30 milion;
2. Turizëm dhe Industri përpunuese, vlera e investimit duhet të jetë minimum 10% e investimeve kapitale, por jo më shumë së 20 milion;
3. Turizëm dhe Industri përpunuese, vlera e investimit duhet të jetë minimum 10% e investimeve kapitale, por jo më shumë së 20 milion;
4. Bujqësi dhe Industri Ushqimore, Parqe Industriale dhe teknologjike; dhe Administrim i ujërave të zeza dhe mbeturinave, vlera e investimit duhet të jetë minimum 10% e investimeve kapitale, por jo më shumë së 10 milion.

3.2. *Në rastet kur një investitor ka shprehur interesim për hapjen e një biznesi në interes të komunës, si:*

1. Investimet në sektorin e prodhimit;

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipality of Kacanik

**01Nr.104/02-11086/21**
**Kaçanik, 29.04.2021**

Në bazë të nenit 12 dhe 14 lidhur me nenin 17 (a) të Ligjit për Vetëqeverisjes Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 11 të Ligjit Nr. 06/L-092- për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare e Republiks së Kosovës Nr.10/03 Prill 2019), të nenit 23.7 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020- Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, të nenit 6.2 të Statutit të Komunës si dhe të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr. 104/02-11086/21 prej datës 16.04.2021, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 29 Prill 2021 mori këtë:

**VENDIM**
**PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË, PËR KATËRDHJETË (40) VJET, PRONËN E PALUAJTSHME TË KOMUNËS, ME PROCEDURË TË NEGOCIMI TË OFERTËS**

**1.** Me këtë Vendim, jepet në shfrytëzim afatgjatë për **Katërdhjetë (40) vjet,** prona e paluajtshme e Komunës, personit juridik: **JLG Construction SH.P.K.-Kaçanik, NUI:811498642, me pronar Agron Zeneli-Kaçanik, me procedurë të negocimit të ofertës.**

**2.** Prona e paluajtshme e dhënë në shfrytëzim, e cekur në pikën 1 të këtij Vendimi është:

2.1 Në pronësi të Komunës, Parcela kadastrale **Nr.70917003-01580-0**, Certifikata për të drejtën e pronësisë me numër të lëndës: 941-10857/21 e datës 15.04.2021**,** në sipërfaqe të tërësishme prej **23.379 m$^2$**, Zona Kadastrale Begracë, Pronë shoqërore, Kullosë e klasës së tretë (3).

2.2 Të bëhet parcelizimi i parcelave nr. **70917003-01580-0** dhe **70917003-01579-0,** Zona Kadastrale Begracë për ndarjen e rezervuarit të ujit nga kjo parcelë konform kushteve të pronës me qëllim të dhënies në shfrytëzim.

**3** Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në pikën 2 të këtij vendimi është për: **Zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe përmbushjes së interesit të përgjithshëm të qytetarëve.**

3.1 Në ofertën e negociuar, JLG Construction SH.P.K.-Kaçanik, planifikon investim në ndërtimin e fabrikës dhe ushtrimin e veprimtarive :

3.1.1 Prodhimin e konstruksioneve metalike të gatshme dhe gjysmë të gatshme për ndërtimin e objekteve të larta të cilat kryesisht do të jenë eksport për ne Evropë – Francë;

3.1.2 Prodhimin e dyerve dhe dritareve të metalit dhe plastikës të destinuar për eksport në Evropë- Francë;

3.1.3 Show room, administrata, Sanitarit etj.

3.1.4 Prodhim të elementeve të tjera metalike për ndërtimin e objekteve të larta sipas nevojave të kontraktuesve në Evropë-Francë.

4. Shuma e planifikuar e investimit e kompanisë së përcaktuar si në dispozitat e pikës 3.1, duke llogaritur rehabilitimin e parcelës, rregullimin e rrugës, ndërtimin e fabrikës dhe objekteve tjera përcjellëse është: 1,000.000.00 (një milion euro) me numër të planifikuar, mesatarisht 70 punëtorë.

5. Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me Kontratë në mes të Kryetarit dhe JLG Construction SH.P.K.-Kaçanik, ku pjesë përbërëse do të jetë, Oferta e JLG Construction SH.P.K.-Kaçanik, NUI:811498642, me pronar Agron Zeneli-Kaçanik, e negociuar për investim në parcelën kadastrale Nr.01580-0 në ZK Begracë.

6. Vendimit i janë bashkangjitur: Propozim Vendimi i Kryetarit të Komunës, Kërkesa e kompanisë, Oferta e kompanisë, Plani dinamik investiv, Certifikatat e pronës, Kopjet e planit, Vendimi paraprak i KK, Certifikata e regjistrimit të biznesit NUI 811498642, Vërtetimi tatimor, Qarkullimi bankar dhe Projekti, ndërkaq pas përfundimit të kontratës, prona i kthehet komunës.

7. E drejta e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme, nuk mund të bartet në shfrytëzim të personave të tretë.

8. Për mbikëqyrjen dhe realizimin e kontratës do të kujdeset, Kryetari i Komunës, i cili konform dispozitave të nenit 22 të Ligjit Nr. 06/L-092 – Për Dhënien në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, obligohet të paraqet raport 6 mujor Kuvendit të Komunës dhe raport të veçantë për realizimin dhe përmbushjen e qëllimit të dhënies së pronave komunale në shfrytëzim si dhe veprimet tjera (masat e caktuara ndaj shfrytëzuesit- përshirë edhe rekomandimin për shkëputje të kontratës) që duhet të merren në rast të mosrealizimit të planit dinamik dhe kushteve të përcaktuara në kontratë.

9. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës. Kryetari i Komunës është i obliguar të njoftoj Kuvendin e Komunës, duke përshkruar gjendjen aktuale të pronës si dhe të jap propozime për destinimin e pronës në të ardhmen, konform pikës 2 të nenit 23 të Ligjit me numër të theksuar si më lartë.

10. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit Ekonomik.

11. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen zyrtare të komunës.

**Me këtë vendim njoftohen:** MAPL, Kryetari i Komunës (përmes Zyrës së Kryetarit njoftohet, pala), Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli

REPUBLIKA E KOSOVËS * KOMUNA E KAÇANIKUT / REPUBLIKA KOSOVA * OPŠTINA KAČANIK

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipality of Kacanik

KRYETARI I KOMUNËS
01Nr.104/02-11086/21
Kaçanik; 16.04.2021

Në bazë të nenit 58, shkronja h të Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale(Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës " nr.28/15, qershor 2008), të nenit 14 paragrafi 1dhe nenit 9 të Ligjit Nr.06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës(Gazeta Zyrtare e Republiks së Kosovs /Nr.10/03 Prill 2019), nenit 23 Rregullore(QRK) Nr.09/2020 Për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 35 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kryetari i Komunës në mbledhjen e radhës të Kuvendi Komunal, i

**PROPOZOJ**

**I.** Kuvendit të Komunës për miratimin paraprak të vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personit juridikë: **JLG Construction SH.P.K.-Kaçanik, NUI:811498642, me pronar Agron Zeneli-Kaçanik.**

**II.**Prona e paluajtshme e dhënë në shfrytëzim, e cekur në pikën 1 të këtij propozimi, është:

1. Në pronësi të Komunës, parcela/t kadastrale, nr.**0917003-01580-0**, certifikata për të drejtën e pronësisë, nr.**941-10857/21**, e dt.**15.04.2021**, në sipërfaqe të tërsishme prej **23.379** m$^2$, Zona Kadastrale Begracë/Pronë shoqërore ( Kullosë e klasës 3).
2. Të bëhet parcelizimi i parcelave nr. **0917003-01580-0** dhe **0917003-01579-0,** Zona Kadastrale Begracë për ndarjen e rezervuarit të ujit nga kjo parcel konform kushteve të pronës me qëllim të dhënies në shfrytëzim/Pronë shoqërore.

**III.** Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në pikën II të këtij propozimi, **është për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe përmbushjes së interesit të përgjithshëm të qytetarëve.**

**IV.**Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II të këtij propozimi, është **afatëgjatë** në periudhën prej **katërdhjetë (40) vite.**

**V.**Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatëgjatë, realizohet përmesë negocimit nga Kryetari i Komunës.

**VI.**Ky propozim hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e marrjes së tij.

Iu dërgohet:

- Kryesuesit të Kuvendit të Komunës dhe
- Arkiva

KRYETARI I KOMUNËS
z. Besim Ilazi

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAČANIK REPUBLIKA KOSOVA

**JLG Construction SH.P.K.**

**NUI.811498642**

**KAÇANIK**

# OFERTË

**PËR : Kryetarin e Komunës Kaçanik – z.Besim Ilazi**

**TEMA : Ofertë për investim në parcelat kadastrale në fsh.Begracë nr.01580-0**

JLG Construction SH.P.K. me NUI.811498642 me adresë në Kaçanik me pronarë Agron Zeneli ID.1172473284 planifikon investimin në ndërtimin e fabrikës dhe ushtrimin e veprimtarive :

- **Prodhimin e konstruksioneve metalike të gatshme dhe gjysmë të gatshme për ndërtimin e objekteve të larta të cilat kryesisht do të jenë eksport për në Evropë-Francë .**
- **Prodhimin e dyerve dhe dritareve të metalit dhe plastikës të destinuara për eksport në Evropë-Francë .**
- **Show room , administrata , Sanitarit etj**
- **Prodhime të elementeve tjera metalike për ndërtimin objekteve të larta sipas nevojave të kontraktuesve në Evropë-France .**

Shuma e planifikuar për të bërë investimin e lartë cekur duke llogaritur rehabilitimin e parcelës , rregullimin e rrugës , ndërtimin e fabrikës dhe objekteve tjera përcjellëse arrin vlerën **1 000 000 € .**

Numri i të punësuarve që kemi planifikuar është mesatarisht **70 puntorë** .

Ne poshtua në Francë posedojmë biznes të njëjtë JLG Construction SAS ku zotërojmë 100% të aksioneve të biznesit . Në këtë biznes kemi siguruar kontrata në vlerë mbi 10 milionë Euro . Në këtë kërkesë gjeni të bashkangjitur dokumentacionin e biznesit që operon në Francë dhe biznesit që e kemi hapur këtu në Kosovë , gjithashtu gjeni të bashkangjitur dokumentacionin e Kapacitetit Financiar të biznesit tonë në Francë në vlerë prej **5 000 000 €** . Biznesi jonë në Francë në rast se Komuna Kaçanik na ofron parcelën për të investuar do ta mbështesim me Financim deri në **2 500 000 €** .

Mbesim me shpresë se oferta jonë do të shqyrtohet dhe do të na jepet mundësia që të investojmë dhe të fillojmë me prodhim në afat sa më të shkurtër .

**Gjeni të bashkangjitur** : Planin e Biznesit , Dokumentacionin e Biznesit në Francë ,Dokumentacionin e mbështetjes Financiare , Dëshmi/Referenca nga punët që kemi kryer në Francë , Gjendjen e Llogarisë Bankare të Biznesit në Kosovë , Planin Financiar , Projektin detaj të ndërtimit .

Dt.12.04.2021

SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR JLG CONSTRUCTION SH.P.K KAÇANIK

DREJTOR GJENERAL

Agron Zeneli

**JLG Construction SH.P.K.**

**NUI.811498642**

**KAÇANIK**

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK

| | | | |
|---|---|---|---|
| Data 12.04.21 | | Vendi KAÇANIK | |
| Nj. org. | Numri | | Shtojcë |
| 01 | 106/02-106791 | | |

# KËRKESË

**PËR : Kryetarin e Komunës Kaçanik – z.Besim Ilazi**

**TEMA : Kërkesë për investim në parcelat kadastrale në fsh.Begracë nr.01580-0**

JLG Construction SH.P.K. me NUI.811498642 me adresë në Kaçanik me pronarë Agron Zeneli ID.1172473284 kërkojmë që të na mundësohet investimin në ndërtimin e fabrikës dhe ushtrimin e veprimtarive :

- **Prodhimin e konstruksioneve metalike të gatshme dhe gjysmë të gatshme për ndërtimin e objekteve të larta të cilat kryesisht do të jenë eksport për në Evropë-Francë .**
- **Prodhimin e dyerve dhe dritareve të metalit dhe plastikës të destinuara për eksport në Evropë-Francë .**
- **Show room , administrata , Sanitarit etj**
- **Prodhime të elementeve tjera metalike për ndërtimin objekteve të larta sipas nevojave të kontraktuesve në Evropë-France .**

Mbesim me shpresë se kërkesa jonë do të shqyrtohet dhe do të na jepet mundësia që të investojmë dhe të fillojmë me prodhim në afat sa më të shkurtër .

Dt.12.04.2021

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
JLG CONSTRUCTION
SH.P.K
KAÇANIK

DREJTOR GJENERAL

Agron Zeneli

**JLG Construction SH.P.K.**

**NUI.811498642**

**KAÇANIK**

# PLANI DINAMIK – INVESTIV

- **FAZA I –**
  ***Koha – 3 muaj***

Projekti ideor

Pastrimi i vend punishtes

Vendosja e rrethojave mbrojtëse

Pikëtimi Gjeodezik

Rregullimi dokumentacionit të ndërtimit

Rregullimi i dokumentacionit të biznesit

- **FAZA II**
  ***Koha – 6 muaj***

Ndërtimi i Objektit

Transportimi i makinave punuese

Montimi i makinave të punës

- **FAZA III**
  ***Koha – 3 muaj***

Përfundimi i ndërtimit të Fabrikës

Përfundimi i Show room, administratës dhe sanitaris

Përgatitja dhe fillimi i punës , kompletimi i stafit .

SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR JLG CONSTRUCTION SH.P.K KAÇANIK

DREJTOR GJENERAL

Agron Zeneli

**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70917003-01580-0

| | |
|---|---|
| **Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:** | **941-10857/21** |
| **Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:** | 15.04.2021 - 10:37 |
| **Komuna / Opština / Municipality:** | KAÇANIK / KAĆANIK / KAÇANIK |
| **Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:** | Begracë / Belograce / Begracë |
| **Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:** | KAÇANIK / KAĆANIK / KAÇANIK |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type | Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type | Zona U/R G/S U/R | Sipërfaqja Površina Area ($m^2$) | Përshkrim Opis Description | Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On | Azhuruar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **P-70917003-01580-0** | **PARCELË / PARCELA / PARCEL** | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | | **23379** | | | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendbanimi - adresa Prebivaliste - adresa Resident - address | Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code | Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address Details | Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On | Azhuruar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|
| TREN MALA FUSHA MOLE/TREN MALA FUSHA MOLE/TREN MALA FUSHA MOLE | | TREN MALA FUSHA MOLE | | |

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAČANIK REPUBLIKA KOSOVA

**Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person**

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Kullosat/Pašnjaci/pasture | Kullosë E Klasës 3/Pasnjak 3 Klase/3rd Class Pasture | 23379 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | **Komuna e Kaçanikut** | 600246913 | / / / | | QAMIL ILAZI | **1/1** | | |

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

**KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN**

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KAÇANIK

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Begracë

941 - 10857/2021

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-70917003-01580-0 | Parcelë / Parcela / Parcel | 23379 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:1847

Punoi/Obradio/Created:
Data/ Data/Date: 15.04.2021
Koha/ Vreme/ Time: 10:38:31
Nënshkrimi/Potpis/Signature:
Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director
Nënshkrimi/Potpis/Signature:

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAČANIK REPUBLIKA KOSOVA

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR /MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA/MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70917003-01579-0

**Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:** **941/01-5182/2019**
**Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:** 22.02.2019 - 08:53
**Komuna / Opština / Municipality:** Kaçanik / Kaćanik / Kaçanik
**Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:** BEGRACË / BELOGRACE / BEGRACË
**Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:** Kaçanik / Kaćanik / Kaçanik

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>(m²) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-70917003-01579-0 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | | 6480 | | | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendbanimi - adresa<br>Prebivaliste - adresa<br>Resident - address | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address Details | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| GLAVICA FUSHA MOLE/GLAVICA FUSHA MOLE/GLAVICA FUSHA MOLE | | GLAVICA FUSHA MOLE | | |

REPUBLIKA E KOSOVËS * KOMUNA E KAÇANIKUT * OPŠTINA KAČANIK * REPUBLIKA KOSOVA

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
